



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1498/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rr. “Armend Daci” nr. 1, Prishtinë, kundër debitorit N.N.T “S...”, me NRB „...”, me adresë ..., me pronar S.S. , ..., Komuna e Rahovecit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.702/2020 të datës 21.10.2020, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 29.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.N.T “S...”, me NRB „...”, me adresë ... - Rahovec, me pronar S.S. , i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.702/2020 të datës 21.10.2020 të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.702/2020 të datës 21.10.2020 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datë 21.10.2020, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.702/2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues- Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.3645, të datës 16.10.2018 , me të cilën është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 6,781.25 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumë përkatëse në llogaritë

e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me tarifatat në fuqi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se edhe pse figuron formalisht si pronar i NNT "S..." i njëjti nuk është marr me veprimtari të jashtëligjshme, për faktin se subjekti afarist nuk zhvillon asnjë veprimtari qe disa vite, e kjo mund të argumentohet edhe me dokumentacionin e ATK-së, por është person tjetër fizik me emrin L.S. i cili është dënua me gjobë administrative dhe se dy persona nuk mund të shpallen përgjegjës dhe të dënohen për të njëjtën veprimtari në të njëjtën kohë, andaj i ka propozuar gjykatës që ta shfuqizoj urdhrin si të jashtëligjshëm dhe të padrejtë.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se i gjithë pretendimi i debitorit është i pa bazuar për faktin se debitori ndaj aktit administrativ ka ushtruar ankesë mirëpo e njëjta është refuzuar dhe akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm. Ka shtuar se propozimi për përmbartim i kreditorit sipas aktit administrativ me Nr.3645 të datës 16.10.2018 si dokument përmbartimor, është në përputhje me nenin 22 par. 1,2, nenin 24 par. 3, nenin 27, nenin 36 par. 1 dhe 2 si dhe nenin 38 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *"Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër."*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Vendimin Nr.3645 të datës 16.10.2018, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Vendimi Nr.3645, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.3645 i datës 16.10.2018, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.3645 i datës 16.10.2018, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është bërë i formës së prerë me datë 24.01.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 08.02.2019.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përbarues mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1498/22, datë 29.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.